

**RREGULLORE  
E KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT  
“PËR MARRËDHËNIET ME MEDIAT”**

*Miratuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve me vendimin nr. 11/1, datë 13.04.2018*

Në mbështetje të nenit 179 pika 7, nenit 179/b të Aneksit të Kushtetutës, nenit 24 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Mbledhja e Gjyqtarëve

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

**Parime të përgjithshme të bashkëpunimit me median**

1. Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim referuar Kolegji) do t'u krijojë kushtet e përshtatshme gazetarëve për të kryer detyrat e tyre, duke i lehtësuar ata sa më shumë që të jetë e mundur.
2. Gazetarët që dëshirojnë të përdorin mjetet e tyre të punës në seancë, duhet të paraqesin kartën e gazetarit të medias që përfaqësojnë. Gazetarëve që nuk zotërojnë kartë që vërteton kredencialet e tyre, u kërkohet të nënshkruajnë protokollin e medias (shih formularin bashkëlidhur). Kolegji do t'u kërkojë mediave me mbulim kombëtar sinjali të akreditojnë punonjësit e ngarkuar me ndjekjen e veprimtarisë së tij.
3. Pranë Kolegjit ushtron detyrën Koordinatori për Median dhe Marrëdhëniet me Jashtë (në vijim referuar Koordinatori për Mediat) nga ora 09:00 deri në 17:00. Koordinatori për Mediat mund të kontaktohet përmes telefonit ose *e-mail*-it.
4. Të gjitha kontaktet e Kolegjit me organet e medias do të menaxhohen nga Koordinatori për Mediat.
5. Faqja e internetit të Kolegjit do të sigurojë informacion rreth aspekteve të përgjithshme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve (të referuar në vijim si procesi i rivlerësimit).
6. Çdo kërkesë për informacion në lidhje me çështje të rivlerësimit, duhet t'i drejtohet Koordinatorit për Mediat, i cili është përgjegjës edhe për koordinimin e nevojshëm brenda institucionit. Kërkesat do të dërgohen, si rregull, në rrugë elektronike.
7. Kolegji do të vërë në dispozicion të medias informacion të përgjithshëm të përditësuar në faqen e tij në internet: [www.kpa.al](http://www.kpa.al)

## Neni 2

### Informimi i medias përpara seancës gjyqësore

1. Koordinatori për Median do të vërë në dispozicion të medias informacion të saktë teknik lidhur me seancat gjyqësore në proces apo ato që planifikohen. Çdo komunikim përtej këtij informacioni teknik është kompetencë e Kryetarit të Kolegjit.
2. Informacioni për seancat gjyqësore mund të merret një javë përpara datës së mbajtjes së tyre.
3. Pasi mediat e kanë marrë informacionin për datën e seancës, Koordinatori për Median mund t'i informojë ato rreth aspekteve faktike të kësaj seance.

## Neni 3

### Roli i medias gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore

1. Seancat gjyqësore pranë Kolegjit janë të hapura për mediat.
2. Gazetarët lejohen të dërgojnë mesazhe të shkruara (SMS) nga pajisjet e tyre *mobile* gjatë seancës gjyqësore. Opsionet e zërit të pajisjeve të tilla, duhet të jenë të çaktivizuara.
3. Kryesuesi i seancës mund ta kufizojë ose ndalojë këtë komunikim (me mesazhe të shkruara) nëse pengon sadopak zhvillimin normal të seancës.
4. Ndalohen regjistrimet audio dhe/ose audiovizuale në mjediset të Kolegjit.
5. Gazetarët që dëshirojnë të bëjnë regjistrime audio (audiovizuale) duhet të kërkojnë leje paraprake nga Koordinatori për Median dhe Marrëdhëniet me Jashtë të paktën 72 orë përpara orës së caktuar për mbajtjen e seancës gjyqësore. Koordinatori për Median përcakton kushtet për të cilat jepet leja.
6. Përpara seancës dëgjimore, në një moment të rënë dakord me Koordinatorin për Median, gazetarët do të kenë mundësi të bëjnë fotografi.
7. Në interes të një zhvillimi të rregullt të seancës gjyqësore, regjistrimet vizuale lejohen vetëm nga një pozicion i caktuar në sallën ku zhvillohet gjykimi, të përcaktuar nga Koordinatori për Median.
8. Në interes të zhvillimit të rregullt të seancës, kryesuesi i trupit gjykues mund të kufizojë numrin e ekipeve me kamera që do të lejohen në sallën e gjyqit. Kolegji mund të përcaktojë si kusht për mediat që do të kenë akses, të bashkëpunojnë për t'u shpërndarë regjistrimet mediave të tjera.
9. Pasi të kenë marrë leje nga Kolegji, mediat lejohen të bëjnë regjistrime (vizuale) të hyrjes në sallë të trupit gjykues dhe të çeljes së seancës nga kryesuesi i trupit gjykues. Më pas, kamerat dhe mikrofonat fiken dhe nxirren jashtë sallës ku zhvillohet seanca gjyqësore.
10. Mediat, gjatë seancës gjyqësore, mund të regjistrojnë vetëm punonjësit e Kolegjit, si dhe të tjerë që gjenden aty për shkak të ushtrimit të detyrës (anëtarët e trupit gjykues të Kolegjit, sekretaren, vëzhguesit ndërkombëtarë, anëtarët e Gardës së Republikës). Nuk

lejohe të regjistrohen në audio (video) personi në proces rivlerësimi, përfaqësuesi/ndihmësi i palës mbrojtëse, dëshmitarët, dëgjuesit në sallë dhe/ose çdo i pranishëm në sallë për arsye jozyrtare.

11. Përveç regjistrimeve të përmendura në paragrafin 3.6 dhe/ose 3.9, nuk lejohe të bëhen regjistrime të tjera video (audio) në mjediset ku zhvillon veprimtarinë Kolegji.

## **Neni 4**

### **Informacioni në lidhje me vendimet e Kolegjit**

1. Mediat audio (vizuale) lejohen të bëjnë regjistrimin e shpalljes publike të vendimit, sipas mënyrës së përshkruar në nenin 3 të kësaj rregulloreje.
2. Në përfundim të çdo procesi gjyqësor, Kolegji do t'ia komunikojë vendimin e marrë personit të rivlerësuar. Ky vendim më pas do të publikohet në faqen zyrtare në internet të Kolegjit. Me anë të këtyre rregullave, Kolegji synon të realizojë një proces sa më transparent dhe në të njëjtën kohë të mbrojë privatësinë e personit të rivlerësuar.

## **Neni 5**

### **Monitorimi dhe zbatimi i rregullave**

1. Kolegji do të monitorojë zbatimin korrekt të rregullave të komunikimit me median.
2. Kolegji do të marrë masat e duhura ndaj përfaqësuesve të mediave të cilët shkelin rregullat e vendosura në këtë rregullore. Në marrjen e masave të duhura, Kolegji do të mbajë parasysh natyrën dhe seriozitetin e shkeljes.

## **Neni 6**

### **Dispozita të fundit**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të saj nga Mbledhja e Gjyqtarëve.
2. Kjo rregullore mund të ndryshohet nga Mbledhja e Gjyqtarëve.

## FORMULAR APLIKIMI PËR LEHTËSIRA PËR MEDIAN

I nënshkruari: \_\_\_\_\_

Emri: \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Numri i telefonit: \_\_\_\_\_

*E-mail-i:* \_\_\_\_\_

Media: \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Numri i telefonit: \_\_\_\_\_

*E-mail-i:* \_\_\_\_\_

Ky formular plotësohet nga përfaqësuesit e mediave për marrjen e lejes për të bërë regjistrime audio (video) në sallën e gjyqit.

**Bashkëlidhur këtij formulari duhet të jetë një kopje e dokumentit që provon identitetin tuaj, i cili të duhet të përmbajë një fotografi në të cilën ju jeni qartësisht i dallueshëm.**

Këto udhëzime për shtyp u ofrojnë anëtarëve të medias (shtypit të shkruar dhe atij elektronik) një perceptim më të qartë të interesave për publikim në lidhje me aksesin e publikut, njohjen e tij me procesin e rivlerësimit, si dhe lidhur me faktin se si dhe nga kush do të peshohen këto interesa. Përveç interesit për informim të publikut, Kolegji duhet të sigurojë edhe të drejtën e privatësisë për personat e përfshirë në procesin e rivlerësimit, të cilët janë të pranishëm në mjediset në të cilat zhvillohet procesi i rivlerësimit apo emrat e të cilëve gjenden në dokumente procedurale, të cilat duhet të mbrohen dhe të mos cenohen në mënyrë të panevojshme.

Kolegji i Posaçëm i Apelimit e merr të mirëqenë faktin se ju jeni njohur tashmë me përmbajtjen e rregullores “Për marrëdhëniet me mediat”.

Të nënshkruarit duhet të sigurojnë se privatësia e të gjithë personave të përfshirë në procesin e rivlerësimit do të respektohet sa herë që të jetë e nevojshme sipas ligjit.

Kolegji rezervon të drejtën për të përjashtuar nga përdorimi i lehtësirave për shtyp që do të ofrojë, personat nënshkrues në rast se ata (ai/ajo) do të thyejnë rregullat e përcaktuara.

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_